



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/1182

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga zv. Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Batisha Ibrahim-Kryesuese, Isa Hasani dhe Kimete Gashi -Anëtar të Panelit duke vendosur sipas (OE) “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të “KOMUNA – RAHOVECË” në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit “NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ri-tenderim” me numër të prokurimit 623-24-8684-5-1-1, me 31/01/2025, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K. me nr. 2024/1182, e datës 05/12/2024, kurse vendimi i AK “KOMUNA – RAHOVECË” lidhur me aktivitetin e prokurimit NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ri-tenderim me numër të prokurimit 623-24-8684-5-1 1.
2. Vërtetohet B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit nga AK – “KOMUNA – RAHOVECË”, të datës 20.11.2024 sipas të dhënave si në pikën I të dispozitivit.
3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.
3. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale --

Me 09.10.2024, "KOMUNA – RAHOVECË" në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ri-tenderim" me nr. të prokurimit: 623-24-8684-5-1-1. Ndërsa me datën 20.11.2024 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. OE "Lika Trade."- Prishtinë

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: - punë, vlera e parashikuar e kontratës: 1, 7,895,292.00 €.

Me 25.11.2024, OE "JOOS & KRASNIQI – BAZE" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 27.11.2024, Autoriteti Kontraktues e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 05.12.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "JOOS & KRASNIQI – BAZE" SH.P.K me nr. 2024/1182 për lidhur me aktivitetin "NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ri-tenderim" me nr. të prokurimit 623-24-8684-5-1-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë OSHP ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "JOOS & KRASNIQI – BAZE" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

Arsyet e lartcekura të autoritetit kontraktues janë të pa bazuara dhe të paqëndrueshme për faktet si në vijim:

1.Sa i përket arsyes së parë të eliminimit tonë nga ana e AK-së, ku disa arsye të eliminimit për kërkesën 2.1. Menaxheri i Projektit, andaj në vijim ne do ta sqarojmë me fakte konkrete që arsyeja e të njëjtës është e paqëndrueshme dhe e pa bazuar.

Pretendimet e AK-së janë se ne kemi prezantuar në ofertën tonë për kërkesën e lartcekur inxhinierin Z. Enver Gashi, referenca të lëshuara nga PEVLAKU për zgjerim të rrugëve nacionale M2-Segmenti Millosheve - Vushtri dhe Zgjerimi I rrugës Nacionale N9- Segmenti Kline-Peje Lot 6, si udhëheqës i projektit, dhe gjithashtu edhe kompania Joos Krasniqi ka lëshuar reference për projektin Zgjerimi I rrugës Nacionale N9- Segmenti Kline-Peje Lot6 si menaxher projekti.

Ne ju sqarojmë se inxhinieri në fjalë, punon që nga viti 2018 në kompaninë tonë si inxhinier I ndërtimtarisë i regjistruar si i punësuar sekondar, andaj i njëjti ka të drejtë të punoj edhe në kompani të tjera me kontrate mbi vepër. Ky fakt nënkupton se gjatë realizimit, të projekteve ka punuar edhe tek kompania jonë si Menaxher i Projektit si dhe tek kompania PE-VLA-KU si udhëheqës i punimeve, për të njëjtin projekt. Andaj nuk qëndron pretendimi i AK-së për eliminimin tonë sepse referencat janë reale dhe duhet të merren parasysh.

Sa i përket pretendimit tjetër lidhur me kontratën e inxhinierit të lartcekur, ju sqarojmë se ne kemi prezantuar kontratën dhe listën e punëtorëve të lajmëruar në ATK, dhe mund ta dëshmojmë edhe me lista më të vjetra se 3 vite të ATK-së se i njëjti inxhinier ka qenë dhe është ende i punësuar nga viti 2018 në kompaninë tonë. Ndërsa në lidhje me CV-në, ju sqarojmë se CV-ja na është dhënë/dërguar nga vet inxhinieri dhe ne nuk kemi bërë ndërhyrje në dokumentet e tij. Pra CV-ja plotësohet nga vet inxhinieri, mirëpo edhe përkundër këtij fakti ne jemi të gatshëm të ju prezantojmë edhe listat më të vjetra se tre vite nga ATK, ku vërtetohet që inxhinieri ka punuar dhe vazhdon të punoj në kompaninë tonë.

Ndërsa sa i përket pagës minimale, ju sqarojmë se në kohën kur është lidhur kontrata e punës paga minimale për punëtorë- sekondare nuk ka qene e përcaktuar 170€, për orarin e përcaktuar ne kontratë dhe se kompania jonë ka pasur një marrëveshje me një zyre të avokateve të cilët I kanë përgatitur kontratat dhe nuk e kanë vërejtur si lëshim Teknik.

Gjithashtu një kërkesë e tillë për pagë minimale nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit, andaj si përfundim ne po eliminohe mi në kundërshtim me dispozitat e nenit 56.3 të LPP-së, e në të cilën dispozitë përcaktohet qartë “3. Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose Kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”.

2 . Në lidhje me arsyen tjetër të eliminimit tonë sa i përket pikës 2.2. Udhëheqësi i Punishtes, ku AK-ja e ka cekur se ne kemi prezantuar Inxhinierin Trimor Gjikotaç, kinse nuk i plotëson kërkesat e përshtatshmërisë si Inxhinier i Ndërtimtarisë drejtimi Konstruktiv, për arsye se profili i tij është Strukturist (jo konstruktiv), ju sqarojmë se arsyetimi i tillë për eliminimin tonë është i paqëndrueshëm.

Inxhinieri i lartcekur ka diplomuar në nivelin Master në Universitetin Politeknik të Tiranës në profilin Strukturist dhe i njëjti tek ne është profil Konstruktiv. Inxhinieri jonë është i diplomuar në Degën Strukturist (ne Shqiperi) mirëpo ky drejtim dhe drejtimi Konstruktiv janë të njëjtat drejtime, mirëpo vetëm emërtimi ndryshon. Pra inxhinieri I prezantuar nga ne është sipas kërkesës së dosjes së tenderit dhe në këtë rast nuk mund dhe nuk duhet të eliminohe mi nga aktiviteti i prokurimit me një arsyetim të tillë.

Ndërsa sa i përket CV-së, ju sqarojmë se CV-ja është e dërguar nga vet inxhinieri dhe ne nuk kemi bërë ndonjë ndërhyrje në dokumentet e tij si dhe përmes referencave të prezantura nga ana jonë për këtë inxhinier dëshmohe t përvoja e tij.

3 . Sa i përket arsyes tjetër të dosjes së tenderit përkatësisht për pikën 2.3. Inxhinier I Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master - Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, ose Bachelor i Ndërtimtarisë - Drejtimi Konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, ku AK-ja na ka eliminuar me arsyetimin se kontrata me inxhinierin e ndërtimtarisë drejtimi

konstruktiv, është nënshkruar nga z. Egzon Berisha, i cili nuk figuron në certifikatën e biznesit të kompanisë Berisha Com Sh.p.k. Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se ne në ofertë kemi dorëzuar autorizimin gjeneral për z. Egzon Berisha si përfaqësues I autorizuar nga Berisha Com SHPK.

Ne nuk e dimë se me çfarë qëllimi nuk është marr parasysh autorizimi i prezantuar për z. Egzon Berisha, mirëpo edhe një herë po e bashkangjesim me qëllim që i njëjti të analizohet edhe një herë dhe të mos eliminohemi me një arsyetim të tillë.?! njëjti autorizim i lejon të njëjtit ti kryej të gjitha nënshkrimet sipas në emër të kompanisë përkatësisht në emër të drejtorit, andaj është i paqëndrueshëm arsyetimi i AK-së për një eliminim të tillë, sepse nuk është e nevojshme të prezantohen disa autorizime apo të prezantohet autorizim i veçantë vetëm për nënshkrim të kontratave.

Ndërsa sa i përket përvojës së inxhinierit z Rexhep Sylejmani, ju sqarojmë se gjatë ofertimit kanë ndodhur disa lëshime teknike ku nuk janë bashkangjitur të gjitha referencat për inxhinierin e prezantuar. Autoriteti kontraktues është dashur të kërkoj sqarime shtesë conform dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së, mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë. Sa për korrektësi ne po ju bashkangjesim edhe një referencë tjetër për inxhinierin të lëshuar nga kompania Saba Bellça SHPK, ku edhe me këtë referencë shihet qartë se inxhinieri i prezantuar nga ne e posedon përvojën e kërkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

4 .Gjithashtu ne jemi eliminuar edhe për faktin se kinse nuk e kemi plotësuar kërkesën 2.4. Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve; • Licenca e Noterizuar e Gjeodetit, për pikën 2.4;

Sa i përket Gjeodetit Rinor Krasniqi të prezantuar nga ne në ofertë, ju sqarojmë se projektet për të cilat kemi paraqitur referencat janë projekte në të cilat inxhinieri në fjalë ka përfunduar në punët e gjeodezisë për projektet e shënuara në Referenca. Ne edhe një herë po I bashkangjesim të njëjtat referenca të cilat kanë qenë edhe në dosjen e ngarkuar nga ne në platformën e E-prokurimit, përmes të cilave vërtetohet përvoja e inxhinierit. Gjithashtu të bashkangjitura gjeni edhe referenca të tjera shtesë për këtë inxhinier, për të cilat AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë nëse eventualisht ka pasur ndonjë dilemë sipas dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Ndërsa sa i përket nënshkrimit të kontratës nga z. Shaban Hoti për kompaninë Joos Krasniqi, ku është cekur se i njëjti nuk figuron në certifikatë të biznesit dhe se në ofertë nuk është prezantuar ndonjë autorizim për nënshkrim të kontratave, ju sqarojmë se edhe kjo arsye e AK- së është e paqëndrueshme.

Ne me ofertë kemi prezantuar edhe autorizimin gjeneral për z.Shaban Hoti si përfaqësues I autorizuar nga JOOS&KRASNIQI-BAZË Sh.p.k. I njëjti autorizim i lejon të njëjtit ti kryej të gjitha nënshkrimet sipas në emër të kompanisë përkatësisht në emër të drejtorit, andaj është I paqëndrueshëm arsyetimi i AK-së për një eliminim të tillë, sepse nuk është e nevojshme të prezantohen disa autorizime apo të prezantohet autorizim i veçantë vetëm për nënshkrim të kontratave.

5. Gjithashtu edhe për kërkesën tjetër të dosjes së tenderit me nr.2.6. Inxhinier i Diplomuar I Hidroteknikës ose Master diplome, me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve;, ne jemi eliminuar me arsyetimin se njëjtë ashtu si në

pretendimin e lartcekur. Andaj edhe në këtë rast ne po e japim pretendimin e njëjtë sikurse më lartë.

Sa i përket inxhinierit Lorik Dervishaj të prezantuar nga ne në ofertë, ju sqarojmë se projektet për të cilat kemi paraqitur referencat janë projekte në të cilat ka qenë i punësuar me kontratë mbi vepër për projektet e caktuara dhe i njëjti posedon referencat e lëshuara nga kompania jonë. Ne edhe një herë po i bashkangjesim të njëjtat referenca të cilat kanë qenë edhe në dosjen e ngarkuar nga ne në platformën e E-prokurimit, përmes të cilave vërtetohet përvoja e inxhinierit. Gjithashtu të bashkangjitura gjeni edhe referenca të tjera shtesë për këtë inxhinier, për të cilat AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë nëse eventualisht ka pasur ndonjë dilemë sipas dispozitave të nenit 59.2 dhe 72 të LPP-së.

Ndërsa sa i përket nënshkrimit të kontratës nga z. Shaban Hoti për kompaninë Joos Krasniqi, ku është cekur se i njëjti nuk figuron në certifikatë të biznesit dhe se në ofertë nuk është prezantuar ndonjë autorizim për nënshkrim të kontratave, ju sqarojmë se edhe kjo arsye e AK- së është e paqëndrueshme.

6. Ne jemi eliminuar me arsyetimin se nuk e kemi plotësuar kërkesën tjetër të dosjes së tenderit: Kërkesa 7: Operatori Ekonomik duhet të ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshira përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet; Dëshmia 7: Originali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe plani i menaxhimit duhet të jetë i vulosur nga kompania;

Në arsyetim AK-ja e ka cekur se plani i dorëzuar nga ne nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit, sepse nuk figuron titulli dhe numri i aktivitetit të prokurimit dhe se plani I nënshkruar nga inxhinieri i komunikacionit z. Zijadin Kastrati nuk përputhet nënshkrimi tek plani i menaxhimit të trafikut dhe tek kontrata e nënshkruar me këtë inxhinier.

Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se kur kemi parasysh se ekzistojnë skicat e njëjta që i kemi marrë nga zyra e Prokurimit e Komunës së Rahovecit, vërehet se ekzistojnë pamjet e njëjta që janë të paraqitura në Plan të Menaxhimit të Trafikut nga ana jonë dhe nuk mund të përkoj me ndonjë aktivitet tjetër të prokurimit. Gjithashtu kërkesë e dosjes së tenderit nuk ka qenë që plani i menaxhimit të trafikut të bëhet me emër të projektit dhe numër tëprokurimit, andaj edhe në këtë rast ne jemi eliminuar në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së, pasi që siç e cekëm edhe më lartë dispozita e lartcekur e specifikon qartë “3. Tenderuesi, gjatëprocedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit

7. Arsyeja tjetër e eliminimit tonë ka të bëjë me kërkesën 9 të dosjes së tenderit ku është kërkuar “Kërkesa 9: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit”.

Për këtë kërkesë ne jemi eliminuar me arsyet si në vijim:

AK-ja për pajisjen Gjysërrimorkio Speciale me sinjalizim digjital për menagjimin e trafikut në rrugë na ka eliminuar se librezja e prezantuar për gjysërrimorkio speciale me sinjalizim digjital për menaxhimin e trafikut në rrugë me tabela 01-650-XB, nuk dëshmohej që është për sinjalizim

digjital sipas kërkesës. Kjo arsye e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se pajisjet e prezantuara nga ana jonë janë sipas kërkesës së dosjes së tenderit, mirëpo që nëse AK-ja ka pasur ndonjë dilemë në lidhje me këtë çështje, atëherë është dashur të kërkoj sqarime shtesë mirëpo një gjë të tillë nuk e ka bërë.

Në lidhje me pajisjen e lartcekur ne si dëshmi po i bashkangjesim edhe fotografitë përmes të cilave dëshmohet se pajisja e prezantuar nga ne është gjysëmrimorkio për sinjalizim digjital për menaxhimin e trafikut ne rruge, Gjysëmrimorkio me targa 01-650-XB.

Për pajisjen Çekan Pneumatikë (hidraulik) që montohet në eskavator min. pesha 2.8-3.0 ton, ne jemi eliminuar me arsyetimin se nuk figuron pesha në faturë për çekanin pneumatik.

Në lidhje me këtë pikë të eliminimit për të dëshmuar të kundërtën e asaj që ka pretenduar AK-ja, ne po e bashkangjesim peshën e Çekanit pneumatik hidraulik i cili është sipas kërkesës së specifikuar në FDT.

Për pajisjen Makinë për saldimin e gypave HDPE-min Fi 800-1200, ne jemi eliminuar se makina e prezantuar nga ne për saldimin e gypave është me peshë 18 kg dhe nuk mund të bëj saldimin e gypave të kërkuar, sepse pajisjet zakonisht peshojnë 300 kg-mbi 1 ton max. Ky arsye i AK-së është i pa bazuar sepse makineria e prezantuar, modeli FRIAMAT prime eco nga prodhuesi Aliaxis / Gjermani, është një makineri që kryen funksionin e saldimin me procesin e elektrofuzionit për rakorderi të ndryshme plastike (PE) nga dimensionin 20mm deri në 1200mm sipas skedës teknike. Peshë prej 18 kg e makinerisë FRIAMAT prime eco nuk ndikon në funksionin që ajo është ndërtuar të kryej. Makineria mund të saldojë me procesin e elektrofuzionit rakorderi të ndryshme plastike (PE) sipas standarteve europiane. Andaj duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se pajisja e prezantuar nga ne është konform kërkesës së dosjes së tenderit.

Për pajisjen Automjet (Autobot për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve), ne jemi eliminuar me arsyetimin se kamioni i cili është në emër të kompanisë Anuar SHPK, nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit sepse në librezë i figuron kamion me vinç për bartjen e kontenjerëve, ndërsa tek shënimi tjetër figuron kamion me vinç dhe cistemë për pastrim të rrugëve, mirëpo jo edhe për kanalizime. Ky arsye i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se automjeti i prezantuar nga ne është Automjet për pastrimin e rrugëve dhe kanalizimeve me tabela 01-886-U, pra i njëjti është sipas kërkesës së dosjes së tenderit, gjë të cilën mund ta dëshmojmë edhe përmes fotove. Në lidhje me këtë pajisje AK-ja është dashur të kërkoj sqarime shtesë, mirëpo që një gjë të tillë nuk e ka bërë, duke na diskriminuar neve si OE I përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Për pajisjen Kamionetë dubelkabinë që posedon pajisje sinjalizuese për njoftim të punimeve në rrugë, ne jemi eliminuar se kamioneta dubelkabinë në librezë nuk figuron që e njëjta posedon pajisjet e kërkuara dhe se librezë nuk është e dukshme.

Sa i përket kësaj arsye të eliminimit ju sqarojmë se nuk qëndron për faktin se për pajisjen Kamionete dubelkabinë me pajisje sinjalizuese ne kemi paraqitur kamionetën e cila i plotëson në tërësi kërkesat e dosjes së tenderit. Pra kamioneta me targa 01-507-SG për të cilën kemi lidhur marrëveshje për marrje me qira me kompaninë Traffiks VA Sh.p. k i përmbush të gjitha kërkesat dhe si dëshmi gjeni Librezën dhe fotografinë e kamionetës.

Për pajisjen Kamion me fshisë që posedon-Spërkatëse për bitumen dhe emulsion, AK-ja ka pretenduar se ne nuk e plotësojmë kriterin për Kamion me fshisë që posedon spërkatëse për

bitumen dhe emuluzion.

Ky arsyetim i AK-së është i paqëndrueshëm për faktin se ne në ofertë kemi paraqitur dy kamionë të këtij lloji ku kamioni me tabela 05-564-EB, ka të shënuar në DUD që i njëjti është kamion për shpërndarjen e emuluzionit dhe të njëjtit mund të përdoren edhe për shpërndarjen e bitumenit pasi që nga gjendja e tyre agregate është e njëjte. Ashtu siç edhe siç dihet nga praktika Bitumeni është njeri nga komponentët për prodhimin e Asfaltit dhe jo pre spërkatje të rrugëve, andaj pajisjet e prezantuara nga ana jonë duhet të merren parasysh dhe nuk duhet të eliminohemi me një arsyetim të tillë.

Për pajisjen Makinë për gërryerjen e asfaltit me peshë min.24-25ton, ne jemi eliminuar me arsyetimin se dokumenti për gërryerjen e asfaltit nga KAG Asphalt është në gjuhën gjermane dhe është në kundërshtim me nenin 13të LPP-së. Në lidhje me paisjen makine për gërryerjen e asfaltit ne kemi paraqitur paisjen me të gjitha dokumentet përcjellëse, andaj supozimet e AK-së për gjuhën nuk janë të arsyeshme, pasi që në faturë të kësaj makinerie të dhënat janë edhe në gjuhë Angleze, mirëpo për korrektësi ne po ju edhe Dud-in dhe faturën e përkthyer, ku vërtetohet se pajisja është sipas kërkesës së dosjes së tenderit.

Për pajisjen Dron professional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, ne jemi eliminuar me arsyetimin si në vijim: Jti nfi ofertë keni prezanluai njfc dokument lëshuar nga : A.VITEH+ i cili sipas dokumentit te prezantuar nuk eshte prodhues , po tregtar/distributor i droneve DJI, keresen e dosjes kan qen qe inxhinieri duhet te te jete i trajnuar/certifikuar për perdorim te dronit professional nga prodhuesi dhe jo nga distributo ri/tregtar.

Arsyeja e lartcekur e AK-së për eliminimin tonë është e paqëndrueshme për faktin se inxhinierin të cilin e kemi prezantuar për përdorimin e dronit dhe i cili njëherit është edhe inxhinier i gjeodezisë, shihet qarte që ky inxhinier posedon certifikatën e kategorisë së trete për përdorimin e automjeteve pa pilot konform RREGULLORE NR. 01/2021 PËR SISTEMET E MJETEVE AJRORE PA PILOT (SAP). Institucioni i vetëm i cili është I autorizuar për certifikimin e piloteve ne Republikën e Kosovës është institucioni i ACC, andaj nga kjo kuptohet që inxhinieri jonë i plotëson të gjitha kushtet për operim në territorin e Republikës se Kosovës për çdo dron që është i përfshirë deri në kategorinë e tretë.

Në arsyen e eliminimit po ashtu është cekur që inxhinieri jonë nuk posedon çertifikatë nga prodhuesi për përdorim të dronit por ka certifikata nga distributori. Ju sqarojmë se një operator i cili mund të ketë një certifikatë nga prodhuesi ose distributor, por i cili nuk është i regjistruar si pilot në regjistrin e ACC, atëherë kjo certifikatë nuk është valide dhe ky operator nuk ka te drejtë operimi ne Republikën e Kosovës.

Gjithashtu ju sqarojmë se kompania DJI është kompani lidere botërore e cila është me seli në Kinë dhe politikat e kësaj kompanie janë të tilla ku operojnë përmes njetit te distributorëve dhe shitësve të autorizuar nga kompania, prandaj çdo person fizik është e pamundur të certifikohet nga prodhuesi drejtpërdrejt, por personat e caktuar mund të certifikohen nga distributorët zyrtar. Andaj si përfundim ne e plotësojmë kërkesën e dosjes së tenderit dhe në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të eliminohemi me një arsyetim të tillë.

8. Gjithashtu ne jemi eliminuar edhe me arsyetimin se disa prej marrëveshje me qera, nuk janë specifikuar pajisjet se për cilat janë lidhur marrëveshjet. Arsyetimi i AK-së se marrëveshjet e prezantuara për marrjen me qera të makinerive me disa kompanitë që ne kemi prezantuar nuk përmbajnë të dhëna se për cilat paisje janë lidhur nuk qëndron sepse ne kemi ofiuar marrëveshje

me qera ku brenda marrëveshjeve është specifikuar Titulli dhe m. i prokurimit për projektin në fjalë dhe gjithashtu në dosje të tenderit nuk ka qenë kërkesë të specifikohet decidivisht se makineritë duhet të figurojnë në marrëveshje. Ne e kemi plotësuar Aneksin 7, dhe asnjë arsye e AK-së për eliminimin tonë në këtë pikë nuk është e qëndrueshme, sepse marrëveshjet janë origjinale dhe të vërtetuara nga noteri ne prani te dy paleve.

9. Në letrën standarde për tenderues të eliminuar ne jemi eliminuar edhe me arsyetimin se kemi bërë ndërhyrje në paramasë. Pretendimi i AK-së për ndërhyrjet në paramasë nga ana jone nuk qëndrojnë sepse ne kemi bërë plotësimin e paramasës ashtu siç është përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktues. Tani pasi që ne kemi ofertuar dhe jemi eliminuar nga AK ne e kemi analizuar paramasën edhe një herë dhe e kemi vërejtur që AK-ja ka vendosur formula nga më të ndryshmet ku ka pasur llogaritje të ndryshme të sasive.

Pasi që me LPP dhe Rregullore ne si kompani nuk jemi të lejuar të bëjmë ndërhyrje në paramasë përkatësisht ne sasi, ne i kemi plotësuar vetëm kolonat të cilat janë përcaktuar nga AK-ja që të plotësojnë operatorët ekonomik ofertues.

Autoriteti kontraktues ka hartuar paramasën gabim apo me qëllim ne nuk e dijmë, pasi që në momentin që ne i kemi plotësuar kolonat e çmimeve autoriteti kishte vendosur formula të cilat vetëm tri pozicionet të cilat i ka përmendur AK-ja të cilat i kanë zbritur sasi të vetvetiu, në momentin që janë dhënë çmimet tek kolona e çmimeve. Ne dyshojmë se këto formula janë vendosur qëllimisht duke anuar ne anën e operatorit ekonomik të shpallur fitues, pasi qe nuk është hera e pare që ndodh një gjë e tillë, dhe fitues i projekteve me gabime te njejta eshte shpallur po i njejti OE.

Së bashku me këtë kërkesë për rishqyrtim ne po i bashkangjesim edhe disa fotografi nga paramasa, përmes të cilave vërtetohet pretendimi jonë ankimor. Pra ne edhe një herë po e sqarojmë se ne e kemi plotësuar tabelën ashtu siç e ka përgatitur dhe përpiluar autoriteti kontraktues dhe ne nuk jemi fajtor përse formula e përpiluar nga AK-së është gabimisht apo i qëllimshëm.

Realisht për gabime të autoritetit kontraktues ne nuk duhet të pësojmë. Për më tepër ne dyshojmë se në këtë rast ekziston një 11 oj kurdisje e këtij tenderi, sepse ne si operator ekonomik e kemi plotësuar tabelën ashtu siç e ka përpiluar autoriteti kontraktues, ndërsa OE i rekomanduar për kontratë e ka plotësuar duke ndryshuar formulat e tabelës së AK- së, e që i bie se OE i rekomanduar për kontratë ka ndërhyrë tek formulat e AK-së dhe është dashur të eliminohet duke pasur parasyshe se ne asnje rast OE-së nuk i lejohet te nderhy ne kolonen e sasive te vendosura nga AK.

Andaj në këtë rast arsyeja e AK-së është e paqëndrueshme për faktin se ne nuk mund dhe nuk duhet në asnjë mënyrë të eliminohe mi nga aktiviteti i prokurimit, me faj të autoritetit kontraktues.

Gjithashtu ju sqarojmë se autoriteti kontraktues e ka rekomanduar për kontratë një OE i cili është i papërgjegjshëm për faktet si në vijim: OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm për faktin se nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Tek aneksi 8 i dosjes së tenderit është specifikuar: Dron profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale dhe rezolucion jo me pak se 40 megapixel. Droni duhet te ketë mundësinë matjes me PPK (Post processing konematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Duhet te prezantohet aprovimi nga ACC per Inxhinier per operimin e dronit te prezantuar (Kopje

e noterizuar nga Inxhinieri). Inxhinieri duhet te jete i trajnuar/certifikuar per përdorim te dronit profesional nga prodhuesi.

Te prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i dronit per dronin dhe kamere.

Nga dokumentacioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë me saktësisht fatura e prezantuar shihet qartë se kompania GEOCAD ka blere dron te modelit Wingtra me mundësi PPK, mirëpo në faturën e prezantuar nuk figuron që OE ka prezantuar ndonjë dokument për posedimin e softuerit për përpunimin e të dhënave PPK. Çdo matje e realizuar me dron duhet te kryhet ne softuer, prandaj shihet qarte qe kompania nuk ka dëshmi për posedimin e softuerit për pëipunim te matjeve me dron me PPK.

Andaj si përfundim OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson kërkesën e lartcekur dhe si I tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit.

Gjithashtu duhet cekur fakti se në këtë aktivitet të prokurimit janë përdorur standarde të dyfishta kundrejt nesh dhe në favor të OE të rekomanduar për kontratë dhe ky fakt vërtetohet nga arsyetimi si në vijim:

Ne arsyet e eliminimit ton është cekur që për inxhinierin e prezantuar për përdorim të dronit nuk kemi prezantuar certificate nga prodhuesi, po kemi prezantuar certificate nga Distributori.

Nga dokumentacioni i prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, shihet qartë që edhe ky OE nuk ka prezantuar certifikatën për inxhinierin nga prodhuesi i dronit por ka prezantuar certifikatën nga shitësi i dronit.

Gjithashtu nga dokumentacioni i prezantuar në ofertë shihet qartë që kompania GeoTech e cila prezantohet si distributor i kompanisë Wingtra ka lëshuar certificate për z. Fidan Hasaj. Nga certifikata shihet qe trajnimi ishte një ditore, certifikata e lëshuar nga kompania shitëse e dronit GeoTech dhe e nënshkruar nga i autorizuari i kompanisë Ylber Shabani. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë nuk e plotëson edhe kërkesën tjetër të dosjes së tenderit ku është specifikuar si në vijim “Kërkesa 6: Operatori Ekonomik duhet te ketë Bazë për prodhimin e Asfaltit me kapacitet min. 240t h, te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje

për furnizim, Bazë për prodhimin e Betonit te licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim, Gurthyes të licencuar ne Pronësi ose marrëveshje për furnizim;”, ndërsa si dëshmi dokumentare është kërkuar “Dëshmia 6: Kopje e noterizuar e licencës e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni per Miniera dhe Minerale në pronësi. Ne rastet kur Operatori Ekonomik ka marrëveshje per furnizim, duhet specifikuar projektin dhe kohëzgjatjen e tij. Marrëveshja duhet te jetë e noterizuar mes qiradhënësit dhe qiramarrësit në prezencë të noterit;”.

OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar marrëveshjet e furnizimit më asfalt, sortues dhe gurëthyes me kompaninë HaxhaKom. Kur analizohen marrëveshjet e tilla figurojnë që janë nënshkruar nga Milot Malaj me autorizim dhe i njëjti nuk figuron në certifikatë të biznesit. Andaj përderisa ne jemi eliminuar për të njëjtën gjë, atëherë edhe OE i rekomanduar për kontratë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit dhe jo të përdoren standarde të dyfishta, duke na eliminuar neve dhe duke e rekomanduar për kontratë të njëjtin OE, i cili është i papërgjegjshëm.

Tek aneksi 8-Lista e pajisjeve obligative, është kërkuar edhe pajisja: Semafor elektrik sinjalizues për menaxhimin e trafikut gjatë punimeve-3 copë. OE i rekomanduar për kontratë në ofertë ka prezantuar një set të semaforëve, mirëpo dihet qartë se seti ka 2 semafor dhe jo tre siç ka qenë

kërkesa e dosjes së tenderit. Andaj nga ky fakt përderisa i njëjti ka prezantuar 2 semafor dhe jo tre siç është kërkuar, kuptohet qartë se i njëjti OE është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga aktiviteti i prokurimit. Duke u bazuar në këto fakte kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë është i papërgjegjshëm dhe si i tillë është dashur të konsiderohet edhe nga ana e AK-së, mirëpo që një gjë e tillë nuk është bërë, duke u favorizuar haptas OE i rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në faktet e lartcekura kuptohet qartë se OE i rekomanduar për kontratë nuk i ka plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit dhe si i tillë është dashur të eliminohet nga ky aktivitet i prokurimit.

Gjithashtu duhet cekur fakti se autoriteti kontraktues me rastin e eliminimit tonë dhe rekomandimit për kontratë të grupit të OE “Lika Company” SH.P.K.; “Lika Trade” SH.P.K., me çmim prej: nuk e ka marr parasysh fare dëmtimin e buxhetit të shtetit ku OE i rekomanduar për kontratë ka ofertuar me çmim prej: 07,886,582.56 €, ndërsa ne kemi ofertuar me çmim prej 6,574,798.22€. Diferenca e çmimit me të cilin ne kemi ofertuar dhe çmimit të OE të rekomanduar për kontratë është në vlerë prej 1,311,784.34 €.

Vërejtje: Ne si kompani e kemi hasur dosjen pothuajse të njëjtë tek 4 tenderë të ndryshëm në 4 autoritete të ndryshme, andaj dyshojmë që ky tender është i kurditur dhe se kërkesat janë përshtatur për OE të rekomanduar për kontratë. Ne me dt.27.11.2024 kemi pranuar vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar mirëpo që në vendim nuk është dhënë asnjë arsyetim konkret të mbështetur në dispozita ligjore konkrete.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj për refuzim të kërkesës për rishqyrtim nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me pretendimet tona ankimore, mirëpo vetëm i ka përshkruar arsyet e eliminimit tonë të cilat janë dhënë në letrën standarde për tenderues të eliminuar.

Me këtë veprim autoriteti kontraktues po dëshmon edhe një herë favorizimin po i bën OE të rekomanduar për kontratë dhe njëkohësisht diskriminimi që po na bëhet neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim shumë më të lirë se sa çmimi i OE të rekomanduar për kontratë. I njëjti pasi që nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën e pretendimeve tona ankimore nuk ka dhënë asnjë arsyetim në lidhje me to, andaj ky veprim tregon qartë se nëse eventualisht arsyetime tona të eliminimit tonë dhe pretendimet tona ankimore kundrejt OE të rekomanduar për kontratë do të ishin të pa bazuara, atëherë AK-ja do të kishte dhënë fakte konkrete duke i kundërshtuar, ato mirëpo pasi që një gjë e tillë nuk e ka bërë, atëherë kuptohet qartë se të njëjtat janë të qëndrueshme.

Në këtë rast autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e nenit 108/A të LPP-së paragrafi 9, ku përcaktohet qartë “9. Refuzimi do të arsyetohet dhe do të komimikohen me shkrim, në përputhje me këtë ligj, parashtruesit të ankesës dhe të gjitha palëve të interesuara, nëse ka ndonjë. Për më tepër autoriteti kontraktues mund të pengojë procedurën e mëtejshme, me pranimin e një njoftimi me shkrim nga ankuesi në lidhje me gatishmërinë e tij për të tërhequr kërkesën e paraqitur për shqyrtim ”.

Autoriteti kontraktues në këtë rast përveç se nuk ka dhënë një arsyetim sipas nenit 108/A paragrafi 9, e njëjta njëkohësisht po vazhdon të mos respektoj edhe nenin 6 të LPP-së, pasi që e ka rekomanduar për kontratë një OE me çmim më të shtrenjtë se sa çmimi i ofertës tonë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë grupi i OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë grupi i operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse është favorizuar grupi i operatorëve ekonomik të rekomanduar për kontratë, ku i njëjti edhe pse nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë është rekomanduar për kontratë, ndërsa neve jemi diskriminuar duke mos na shpallur fitues edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe kemi ofertuar me çmim më të ulët.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së, e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (yi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Gjithashtu nuk është marrë në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efektive, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u referuar pretendimeve si më sipër “JOOS & KRASNIQI – BAZE” SH.P.K konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 52, 56,3, 59, 60, 69, dhe 72 të LPP-së Duke pasur parasysh të gjitha faktet dhe argumentet që u cekën më lartë, kërkojmë nga OSHP- ja që të marrë: VENDIM të APROVOHET, si e bazuar ankesa e OE JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K. & BERISHA COM SH.P.K. & ALBAVIA SH.P.K. dhe të ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në RIVLERËSIM, ndërsa rivlerësimi i ofertave të bëhet sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe konform kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë përndryshe ne do të detyrohemi të vazhdojmë me ankesa dhe kundërshtime për këto shkelje në instancat tjera më të larta.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: Grup i Operatorëve Ekonomik: JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K.;

Albavia sh.p.k. me adresë në JUNIK, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ritenderim, me Numër të prokurimit: 623-24-8684-5-1-1, Numër i brendshëm: 623-24-056-5-1-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK-së, të datës: 20.11.2024, të publikuar në ueb-faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë: 25.11.2024, sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042.

BAZA LIGJORE PËR REFUZIM TË KËRKESËS Ju sqarojmë se pretendimet e tua ankimor nuk qëndrojnë dhe janë të pabazuar, pasi që vlerësimi i ofertave është bërë konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik Autoriteti Kontraktues: Komuna e Rahovecit, ju ka Njoftuar juve si Operator Ekonomik ankues, sipas formularit B42 Letër Standarde për tenderuesin e eliminuar, ku kemi cekur:

ARSYETIM: Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye: Ju njoftoj se ju si O.E. nuk i keni plotësuar kërkesat minimale sipas Dosjes së tenderit të Seksioni II. Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT): Kapaciteti teknik dhe profesional:

Kërkesa 2: Operatori Ekonomik duhet të ketë në listën të paktën këtë staf profesional:

2.1. Menaxheri i Projektit – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte të menaxhuara në zgjerim të rrugëve;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);
- CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për projekt duhet të jete e noterizuar në prani të palëve);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;
- Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2;

Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Menaxherit të Projektit, keni prezantuar z. Enver Gashi; Për Inxhinierin në fjalë, është kërkuar Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi dhe të ketë dëshmi se ka menaxhuar projekte të realizuara në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte të menaxhuara në zgjerim të rrugëve;

Referenca e lëshuar nga Kompania: PEVLAKU, figuron që i njëjti ka qenë udhëheqës i punishtes në dy projekte të zgjerimit të rrugëve, dhe jo menaxher i projektit ashtu siç është specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit. Projektet për zgjerim të rrugëve të cilat janë specifikuar në referencë janë: “Zgjerimi i Rrugës Nacionale M2-Segmenti Milloshevë-Vushtrri” dhe “Zgjerimi i rrugës Nacionale N9- Segmenti: Klinë-Pejë Lot 6”. Gjithashtu për të njëjtin inxhinier është prezantuar edhe një referencë e lëshuar nga vetë Lideri i këtij Grupi: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., ku edhe në këtë referencë shënon projekti i njëjti i cili është shënuar në referencën e lartcekur “Zgjerimi i rrugës Nacionale N9-Segmenti: Klinë-Pejë Lot 6”, mirëpo që në këtë rast të njëjtit i figuron pozita menaxher dhe jo udhëheqës i punishtes. Në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje në mes të dëshmive, pasi që për të njëjtin projekt janë

lëshuar dy referenca nga dy kompani të ndryshme, ku njëra e ka cekur se inxhinieri ka qenë udhëheqës i punishtes, ndërsa tjetri menaxher.

Gjithashtu është prezantuar edhe kontrata e lidhur në mes të inxhinierit dhe Kompanisë: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., e cila figuron që është lidhur me datë: 01.10.2018, mirëpo në CV në e të njëjtit nuk figuron që ka punuar tek kompania juaj. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje në mes të dëshmive të prezantuara. Po ashtu në kontratën e lartcekur është shënuar paga 150 euro, mirëpo sipas ligjit që ka qenë në fuqi në kohën e nënshkrimit të kontratës, inxhinieri i lartcekur ka qenë 40 vjeçar dhe sipas ligjit në fuqi në atë kohë paga minimale për punëtorët mbi 35 vjeç ka qenë 170 euro në muaj, ndërsa edhe në kontratë shënohet që paga nuk mund të jetë më e ulët se paga minimale. Për këtë rast ekzistojnë edhe praktika të mëhershme, vendime të OSHP-së, përkatësisht vendimi me Nr. 837-841-19, i datës: 26.12.2019. Po ashtu në dëshminë e prezantuar nga ATK për inxhinierin e lartcekur figuron që nuk e ka punë primare punën tek kompania juaj, ndërsa në kontratë figuron orari i plotë, prandaj edhe në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje në mes të dëshmive të prezantuara.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së. 2.2. Udhëheqësi i Punishtes – Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 5 vite pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka udhëhequr projekte të realizuara në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku dy (2) projekte të udhëhequr ne zgjerim të rrugëve;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);
- CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për projekt duhet të jete e noterizuar në prani të palëve);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;
- Një deklaratë me shkrim për caktimin e Menaxherit të Projektit dhe Udhëheqësit të Punishtes – duhet të dorëzohet në origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur nga Operatori Ekonomik për pikën 2.1 & 2.2;

Sqarimet janë si në vijim:

Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Udhëheqësi i Punishtes, keni prezantuar z. Trimor Gjokokaj; Për Inxhinierin në fjalë, është kërkuar: Drejtimi Konstruktiv, ndërsa në Diplomën e prezantuar me Numër Diplome: M-1051, për këtë Inxhinierin ceket Profili: Strukturist, dhe Jo Konstruktiv, siç është specifikuar në kërkesën e lartcekur, po ashtu i njëjti ka diplomuar me datë: 20.03.2018, ndërsa në CV-në e tij figuron që i njëjti i ka përvojë pune vetëm 4 muaj pas diplomimit dhe atë tek Kompania: NTSHN ARFA, pra sipas CV-së i njëjti nuk e plotëson përvojën prej 5 viteve të kërkuara pas diplomimit.

Bazuar në tabelarin e UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK, në faqen 40 kemi shembullin se si duhet vepruar: Në ofertë janë prezantuar edhe dy referenca nga lideri i

grupit: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., dhe kontrata e lidhur figuron që është lidhur me datë: 01.08.2018, mirëpo në CV nuk figuron askund që i njëjti ka punuar tek ju si kompani. Po ashtu nga dëshmitë e prezantuara nuk dëshmohet që inxhinieri i lartcekur ka se paku dy (2) projekte të udhëhequr në zgjerim të rrugëve. Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së.

2.3. Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master – Drejtimi Konstruktiv, me përvojë pune min. 3 vite pas diplomimit, ose Bachelor i Ndërtimtarisë – Drejtimi Konstruktiv, me 5 vite përvojë pune pas diplomimit, Të ketë dëshmi se ka realizuara projekte në lëmine e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve. Të jete i certifikuar për mbrojtje dhe siguri në punë;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);
- CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për projekt duhet të jete e noterizuar në prani të palëve);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëmin e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;
- Certifikata e noterizuar për dhënien e provimit profesional nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë e lëshuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, për pikën 2.3;

Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Inxhinier i Diplomuar Ndërtimtarisë ose Master– Drejtimi Konstruktiv, keni prezantuar z. Rexhep Sylejmani; Për Inxhinierin në fjalë, është kërkuar: Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, ndërsa në ofertën e juaj për këtë Inxhinier keni prezantuar: Që është në kundërshtim me Nenin 2 të kësaj kontrate, ku ceket: Kontrata e nënshkruar nëpërmjet Palëve Kontraktuese, nga Kompania: BERISHA COM SH.P.K., në emër të Punëdhënësit, është bërë nga z. Egzon Berisha, ku personi në fjalë NUK është në Certifikatën e Biznesit si Pronarë, po ashtu në ofertën e dorëzuar nuk ka prezantuar ndonjë Autorizim nga Kompania për nënshkrim të kontratave; Nënshkrimi apo Noterizimi i ndonjë dokumenti nga personi i cili nuk është drejtor bie ndesh shprehimisht me Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në të cilin thuhet: “Secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësoj Shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar si Përfaqësues i autorizuar gjatë ushtrimit të Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin: 1.1 për udhëheqjen e Veprimtarisë së saj Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe 1.2 për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në se ky nënshkrim ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar. Cilido prej atyre veprime të drejtoreshave menaxhuese e obligojnë Shoqërinë me të Kufizuar, përveç nëse Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përcakton që disa ose të gjithë Drejtorët Menaxhues do të përfaqësojnë bashkërisht Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. Përfaqësimi i Përbashkët vlen ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet nga ARBK-ja, sipas nenit 22 të këtij ligji. 2. Me kryerjen e transaksioneve në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të

Kufizuar, sa i përket Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtorët menaxhues janë të obliguar të zbatojnë kufizimet e përcaktuara me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo vendosur me votën e Aksionarëve apo Bordit të drejtorëve. Kufizimi i së drejtës së përfaqësimit nuk vlen ndaj palëve të treta. 3. Cilido person, përfshirë drejtorin menaxhues, i cili me dijeni pretendon se vepron në emër të shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, është personalisht përgjegjëse për të gjitha dëmet që janë shkaktuar Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nga këto veprime. “ E njëjta çështje është sqaruar me pyetjet e shpeshta të KRPP e ku në pyetjen nr. 40, është sqaruar se personat të cilët nuk janë pjesë e informative të biznesit si palë e autorizuar, nuk mund të nënshkruajnë në emër të operatorit.

Po ashtu për Inxhinierin në fjalë, nuk është prezantuar dëshmi që i njëjti posedon përvojë për projekte të realizuara në lëminë e kërkuar sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së. 2.4. Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte ne zgjerim te rrugëve;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri te noteri);
- CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata te rregullt te dëshmohet me liste te ATK ne tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje per projekt duhet te jete e noterizuar ne prani te palëve);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;
- Licenca e Noterizuar e Gjeodetit, për pikën 2.4;

Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Inxhinier i Diplomuar ose Master i Gjeodezisë, keni prezantuar z. Rinor Krasniqi;

Kontrata e nënshkruar nëpërmjet Palëve Kontraktuese, nga Kompania: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., në emër të Punëdhënësit, është bërë nga z. Shaban Hoti, ku personi ne fjalë NUK është në Certifikatën e Biznesit si Pronarë, po ashtu në ofertën e dorëzuar nuk ka prezantuar ndonjë Autorizim nga Kompania për nënshkrim të kontratave; Nënshkrimi apo Noterizimi i ndonjë dokumenti nga personi i cili nuk është drejtor bie ndesh shprehimisht me Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në të cilin thuhet: “Secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësoj Shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar si Përfaqësues i autorizuar gjate ushtrimit të Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin: 1.1 për udhëheqjen e Veprimtarisë së saj Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe 1.2 për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në se ky nënshkrim ndërlidhet në masë të arsyeshme me ushtrimin e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar. Cilido prej atyre veprime të drejtoreshve menaxhuese e obligojnë Shoqërinë me të Kufizuar, përveç nëse Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

përcakton që disa ose të gjithë Drejtorët Menaxhues do të përfaqësojnë bashkërisht Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. Përfaqësimi i Përbashkët vlen ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet nga ARBK-ja, sipas nenit 22 të këtij ligji. 2. Me kryerjen e transaksioneve në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, sa i përket Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtorët menaxhues janë të obliguar të zbatojnë kufizimet e përcaktuara me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo vendosur me votën e Aksionarëve apo Bordit të drejtorëve. Kufizimi i së drejtës së përfaqësimit nuk vlen ndaj palëve të treta. 3. Cilido person, përfshirë drejtorin menaxhues, i cili me dijeni pretendon se vepron në emër të shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, është personalisht përgjegjës për të gjitha dëmet që janë shkaktuar Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nga këto veprime. “ E njëjta çështje është sqaruar me pyetjet e shpeshta të KRPP e ku në pyetjen nr. 40, është sqaruar se personat të cilët nuk janë pjesë e informative të biznesit si palë e autorizuar, nuk mund të nënshkruajnë në emër të operatorit.

Inxhinieri në fjalë ka diplomuar me datë: 11.10.2019, ndërsa nga dëshmitë e prezantuara, nuk figuron që i njëjti ka realizuar se paku 2 projekte në zgjerim të rrugëve. Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së.

2.6. Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës ose Master diplome, me (3) tri vite përvojë pune pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka realizuar projekte në lëminë e ndërtimit, asfaltimit dhe rehabilitimit të rrugëve, si dhe se paku 2 projekte në zgjerim të rrugëve;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Diplomat përkatëse – Kopje të noterizuar, (noterizimi të prezantohet nga vetë inxhinieri të noteri);
- CV-ja (e nënshkruar nga vete inxhinieri);
- Kontrata e punës me punëdhënësin ose marrëveshja mbi angazhim për këtë projekt, (Nëse prezantoni kontrata të rregullt të dëshmohet me liste të ATK në tre (3) muajt e fundit, nëse prezantoni marrëveshje për projekt duhet të jete e noterizuar në prani të palëve);
- Letër referencë për punët e mëparshme në lëminë e kërkuar e lëshuar nga punëdhënësi;

Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, për pozitën e Inxhinier i Diplomuar i Hidroteknikës ose Master, keni prezantuar z. Lorik Dervishaj;

Kontrata e nënshkruar nëpërmjet Palëve Kontraktuese, nga Kompania: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., në emër të Punëdhënësit, është bërë nga z. Shaban Hoti, ku personi në fjalë NUK është në Certifikatën e Biznesit si Pronarë, po ashtu në ofertën e dorëzuar nuk ka prezantuar ndonjë Autorizim nga Kompania për nënshkrim të kontratave; Nënshkrimi apo Noterizimi i ndonjë dokumenti nga personi i cili nuk është drejtor bie ndesh shprehimisht me Nenin 109 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare në të cilin thuhet: “Secili drejtor menaxhues është i autorizuar që ta përfaqësoj Shoqërinë me Përgjegjësi të kufizuar si Përfaqësues i autorizuar gjatë ushtrimit të Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike, duke përfshirë edhe autorizimin: 1.1 për udhëheqjen e Veprimtarisë së saj Ekonomike të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar; dhe 1.2 për nënshkrimin e marrëveshjeve ose dokumenteve tjera të nevojshme për ushtrimin e Veprimtarisë Ekonomike në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në se ky nënshkrim ndërlihet në masë të arsyeshme me ushtrimin e Veprimtarisë së zakonshme Ekonomike të

Shoqërisë me Përgjegjësi të kufizuar. Cilido prej atyre veprime të drejtove menaxhuese e obligojnë Shoqërinë me të Kufizuar, përveç nëse Statuti i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar përcakton që disa ose të gjithë Drejtorët Menaxhues do të përfaqësojnë bashkërisht Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar. Përfaqësimi i Përbashkët vlen ndaj palëve të treta vetëm nëse publikohet nga ARBK-ja, sipas nenit 22 të këtij ligji. 2. Me kryerjen e transaksioneve në emër të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, sa i përket Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, drejtorët menaxhues janë të obliguar të zbatojnë kufizimet e përcaktuara me Statutin e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar apo vendosur me votën e Aksionarëve apo Bordit të drejtorëve. Kufizimi i së drejtës së përfaqësimit nuk vlen ndaj palëve të treta. 3. Cilido person, përfshirë drejtorin menaxhues, i cili me dijeni pretendon se vepron në emër të shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar në shkelje të detyrimeve të përcaktuara në paragrafin 2 të këtij neni, është personalisht përgjegjëse për të gjitha dëmet që janë shkaktuar Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar nga këto veprime. “ E njëjta çështje është sqaruar me pyetjet e shpeshta të KRPP e ku në pyetjen nr. 40, është sqaruar se personat të cilët nuk janë pjesë e informative të biznesit si palë e autorizuar, nuk mund të nënshkruajnë në emër të operatorit.

Po ashtu për të njëjtin Inxhinier keni prezantuar referenca të lëshuara nga Kompani: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K., mirëpo në CV-në e prezantuar nuk figuron që i njëjti ka punuar tek ju si kompani. Pra në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje mes dëshmimeve të prezantuara. Gjithashtu nga dëshmitë e prezantuara nuk e keni dëshmuar që i njëjti ka përfunduar së paku dy projekte në zgjerim të rrugëve.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së. Kërkesa 7: Operatori Ekonomik duhet të ofroj se bashku me oferte planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar duke përfshirë përshkrimin dhe skicat e rrugës e cila do të realizohet;

Dëshmia e kërkuar dokumentare

Dëshmia 7: Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit dhe plani i menaxhimit duhet të jetë i vulosur nga kompania;

Sqarimet janë si në vijim: Në ofertën e juaj të dorëzuar, plani i prezantuar nga ju nuk përkon me këtë aktivitet të prokurimit, pasi që askund nuk figuron titulli dhe numri i prokurimit për këtë aktivitet. Po ashtu është kërkuar që planit të menaxhimit të trafikut të jetë i nënshkruar nga Inxhinieri ose Bachelor i Komunikacionit.

Plani i prezantuar është nënshkruar nga Inxhinieri i Komunikacionit z. Zijadin Kastrati, të cilin Inxhinier e keni prezantuar tek Kërkesa Nr. 2.5 të Kapaciteti teknik dhe profesional, por në këtë rast kemi të bëjmë me mospërputhje mes dëshmimeve të prezantuara, pasi që në planin për menaxhimin e trafikut të punuar nga Inxhinieri në fjalë kemi një nënshkrim tjetër, ndërsa te kontrata e prezantuar me këtë Inxhinier, kemi një nënshkrim tjetër. Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së.

Kërkesa 9: Operatori Ekonomik duhet të posedojë mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit, pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm sipas tabelës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit;

Dëshmia e kërkuar dokumentare Dëshmia 9: Operatori ekonomik duhet të plotësojë listën e pajisjeve sipas kërkesës në Aneksin 8 të Dosjes së Tenderit, Lista e pajisjeve e nënshkruar dhe e vulosur nga Operatori Ekonomik si dhe Lista e pajisjeve duhet të jete e noterizuar nga Noteri në

formë të Aktit Noterial, ku listës së pajisjeve duhet ti bashkëngjiten edhe dëshmitë e noterizuara mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapaciteteve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listës se ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit), Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (pajisjet duhet te jene me afat te regjistrimit), ndërsa pajisje tjera Operatori Ekonomik duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (Faturë, DUD ose kontratat e shitblerjes. etj.)

Vëmendje! Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët në prezencë të noterit; Dëshmitë per pajisjet duhet te ofrohen te renditura sipas listës se bashkangjitur ne Aneksin 8 te Dosjes se Tenderit, Gjithashtu të epen karakteristikat gjegjësisht specifikat teknike të veçanta per secilën nga pajisjet, Dëshmitë duhet te jene te dukshme;

Lista e mjeteve, stabilimentet dhe pajisjet teknike të dorëzuar nga ana juaj: Gjithashtu në ofertën tuaj ju keni prezantuar marrëveshje/kontrata për marrjen me qira të pajisje të prezantuara në ofertë si në vijim:

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe Rahovica Commerce SH.P.K.;

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe NNT ABC SH.P.K.;

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe FSC ING SH.P.K.;

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe EUROVIA SH.P.K.;

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe KAG-Asphalt Company SH.P.K.;

Marrëveshja JOOS&KRASNIQI-BAZE SH.P.K. dhe PZP Valjevo;

Marrëveshjet e përmendura më lartë nuk figurojnë se për cilat pajisje janë lidhur, andaj të njëjtat nuk mund të mirren parasysh nga ana e Autoritetit Kontraktues, sepse nuk dihet se për cilat pajisje janë lidhur. Për të u konsideruar një marrëveshje valide, atëherë është dashur të përmenden edhe pajisjet se cilat do të merren me qira.

Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform nenit 59.4 të LPP-së AK gjatë vlerësimit te ofertave kemi konstatuar se Grup i Operatorëve Ekonomik: JOOS & KRASNIQI – BAZE SH.P.K.; BERISHA COM SH.P.K.; Albavia sh.p.k, ka bërë ndërhyrë ne paramase, peraktësishtë:

Ne pozicionin Nr. 1.4.6: Furnizimi dhe punimi i tamponit (100MN/m²) prej gurit të thyer gëlqeror 0-31.5mm me trashësi t=20cm, ne kete shtrese eshte llogaritur edhe sasia per rregullimin e gjeometrise ne kthesa dhe ne drejtim. Sasia e llogaritur në gjendje të ngjeshur,

Njësia matëse: m³ , Sasia: 14250.00 m³ , duke e ndryshuar Sasinë ne: 13950.00 m³

Ne pozicioni Nr. 2.3.4: Furnizimi, transporti dhe vendosja e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa, Njësia matëse: m³ , Sasia: 1100.00 m³ , duke e ndryshuar Sasinë ne: 1092.00 m³

Ne pozicionin Nr. 2.3.5: Mbulimi dhe planifikimi i kanalit me materail mbushes CBR 15 % dhe ngjeshja në shtresa 25cm deri në trupin e rruges. Mbulimi deri ne shtresen e nenbases se trupit te

rruges, Njësia matëse: m³ , Sasia: 2750.00 m³ , duke e ndryshuar Sasinë ne: 2758.00 m³

Me rastin e ofertimit çdo OE ofertues zotohet se i ka kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e Dosjes së Tenderit kjo evidentohet edhe tek Formulari për dorëzimin e Tenderit i cili është i bashkangjitur në ofertën e tij, por është e përcaktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim

Publik, citat: "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve". Sqarojmë se ndryshimi i sasive nuk ka të bëjë me gabime aritmetikore, gabimet aritmetikore janë të përcaktuara qartë tek Rregullorja e lartë cekur tek paragrafi 8 dhe 9 i nenit 41.

Për këtë rast ekzistojnë edhe praktika të mëhershme nga OSHP-ja, Vendime të OSHP-së, përkatësisht Vendimi OSHP: 2023/0931, dhe Vendimi PSH nr. 399/22; Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së; Nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij Vendimi

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 06.12.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 1182/24, ndërsa me datë 30.12.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/1182 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, ndërsa mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK pajtohet rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues, dhe po ashtu OE nuk pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

OSHP ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore lidhur me rastin.-

-Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE "JOOS & KRASNIQI – BAZE" SH.P.K- eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2024/1182 ka vlerësuar si në vijim:

Pretendimi nr.1 : Pretendimi kryesor ankimore sipas ankesës 1182/24 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues, konkretisht me ndryshimin e sasive të kërkuara nga AK në paramasë.

OE pretendon se i njëjti nuk ka bërë ndryshim të sasive, porse paramasa/formula e vendosur nga AK, me rastin e plotësimit të çmimit automatikisht ka ndryshuar sasinë.

OE ankues shpreh dyshimet e veta se ky gabim në formulë të paramasës është bërë me qëllim nga ana e AK-së.

Në anën tjetër, AK ën refuzim të kërkesës për rishqyrtim thekson se :

“Me rastin e ofertimit çdo OE ofertues zotohet se i ka kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e Dosjes së Tenderit kjo evidentohet edhe tek Formulari për dorëzimin e Tenderit i cili është i bashkangjitur në ofertën e tij, por është e përcaktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve". Sqarojmë se ndryshimi i sasive nuk ka të bëjë me gabime aritmetikore, gabimet aritmetikore janë të përcaktuar qartë tek Rregullorja e lartë cekur tek paragrafi 8 dhe 9 i nenit 41. Për këtë rast ekzistojnë edhe praktika të mëhershme nga OSHP-ja,

Vendime të OSHP-së, përkatësisht Vendimi OSHP: 2023/0931, dhe Vendimi PSH nr. 399/22; Andaj oferta juaj konsiderohet e papërgjegjshme konform LPP-së;”.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, ankesës dhe pretendimeve ankimore, dosjes së tenderit dhe paramasës, si dhe vendimit të AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, fillimisht vlen të theksohet se dosja e tenderit, konkretisht paramasa/përshkrimi i çmimeve përmban gabime në formulë, ashtu siç pretendon OE ankues.

Megjithatë, nga praktika e deritanishme në OSHP përmes vendimeve: nr.382/24, nr.931/23, 49/23, gabimet e formulës në paramasë/përshkrim të çmimeve të vendosur nga AK, nuk janë lejuar të përdoren as si arsye për anulim të aktivitetit.

Më konkretisht përmes vendimit 931/23, ku OE ankues ka qenë po ky operator ekonomik, paneli shqyrtues në arsyetim të vendimit ndër të tjera konstaton:

“Andaj, Paneli duke u nisur nga ky fakt se OE tjerë nuk i kanë prekur sasinë e përcaktuara nga AK, ndërsa ankuesi ka ndryshuar sasinë në paramasë me apo pa qëllim, atëherë ankuesi ka qenë dashtë këtë ta evidentoj në fazën e para ofertimit dhe të marrë masa ta përmirësoj këtë gjë, po ashtu nëse kishte me qenë e nevojshme edhe me ankesë në AK dhe OSHP. Kurse, me rastin e ofertimit çdo OE ofertues zotohet se i ka kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e Dosjes së Tenderit kjo evidentohet edhe tek Formulari për dorëzimin e Tenderit të ankuesit i cili është i bashkangjitur në ofertën e tij, por e përcaktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve". Paneli sqaron se ndryshimi i sasive nuk ka të bëjë me gabime aritmetikore, gabimet aritmetikore janë të përcaktuar qartë tek Rregullorja e lartë cekur tek paragrafi 8 dhe 9 i nenit 41. Si rezultat i gjithë këtyre veprimeve/mosveprimeve të cituara si më sipër, paneli shqyrtues mbështet arsyetimin e autoritetit kontraktues dhe raportin e ekspertit shqyrtues se ky OE ankues me të drejtë është eliminuar nga ky aktivitet i prokurimit.”.

Në rastin konkret vlerësojmë se kemi të bëjmë me situatë të njëjtë me ankesën 931/23 sa i përket formulës së përmasës dhe eliminimit të OE.

Bazuar në gjitha këto që u cekën më lart, si dhe bazuar në vendimet e OSHP-së për raste të njëjta, konsiderojmë se pretendimi ankimore është i pabazuar.

Pretendimi nr.2 : Sa i përket pretendimeve ankimore për menaxherin e projektit, AK në arsyetim të eliminimit përveç arsyeve tjera siç janë paga minimale, vendet e punës të këtij presonim etj, si arsyetim të eliminimit ka dhënë se personi konkret nuk ka dëshmuar përvojën në cilësi të menaxherit të projektit, për dy projekte në zgjerim të rrugëve.

OE ankues në ankesën e tij, jep sqarime dhe arsyetim sa i përket pagës, vendeve të punës të personit në fjalë etj, mirëpo nuk pretendon se personi në fjalë ka përvojë në cilësi të “menaxherit” për projekte të zgjerimit të rrugëve.

Bazuar në këto që u cekën më lart vlerësojmë se pretendimi ankimore është i pabazuar.

Pretendimi nr.3 : Sa i përket pretendimeve tjera ankimore, lidhur stafin, pajisjet, marrëveshjet për qiramarrje të pajisjeve etj, konsiderojmë se janë pjesërisht të bazuara, pasi pas analizimit të shkresave të lëndës vlerësojmë se për këto pretendime ankimore ka pasur meritë që të paktën të kërkohet sqarime shtesë nga ana e AK-së.

Megjithatë bazuar në përgjigjet e dhëna në pretendimet 1 dhe 2, kthimi i lëndës në rivlerësim me qëllim të sqarimeve të mëtutjeshme nuk do të sillte ndryshim në rezultat final sa i përket përgjegjshmërisë së OE ankues.

Pretendimi nr.4. : Pretendimet ankimore kundrejt OE të rekomanduar, se i njëjti nuk ka ofruar licencë për softuerin e dronit, vlerësojmë se një gjë e tillë (licenca softuerit) nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit andaj nuk mund të përdoret si arsyetim për vlerësim ose eliminim të OE, rrjedhimisht vlerësojmë se pretendimi ankimore është i pabazuar.

Pretendimi nr.5 : OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë lidhur me kërkesën për “Inxhinieri duhet te jete i trajnuar/certifikuar per perdorim te dronit professional nga prodhuesi”.

Ndërsa OE i rekomanduar për kontratë ka ofruar dëshmi nga distributori.

OE ankues thekson se për të njëjtën dëshmi ai vet është eliminuar nga aktiviteti prokurimit, ndërsa OE tjetër rekomandohet për kontratë.

Pas analizimit të shkresave të lëndës, kemi gjetur se OE i rekomanduar për kontratë njëjtë sikurse OE ankues kanë ofruar dëshmitë nga dileri/distributori, andaj vlerësojmë se vendimi i AK-së për eliminim të OE ankues dhe rekomandim të OE tjetër për kontratë është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së.

Megjithatë duhet të theksojmë se kjo kërkesë nuk është kërkesë e FDT-së por është kërkesë e aneksit 1 specifikacionit teknik.

Vlen të theksohet se në rastin konkret kemi të bëjmë me trajnim për pilotim të dronëve, dhe për dallim nga psh... pajisjet medicinale, ku është praktikë e zakonshme që stafi i kompanive që bën instalimin/montimin të trajnohet nga vet prodhuesi (mirepo edhe ne kete rast perdoruesit e aparatures trajnohet nga perfaqesuesi/distributeri), në rastin e dronëve kemi të bëjmë me pajisje

relativisht të lira, që shiten në numër shumë më të madh dhe në praktikë trajnimet për fluturim të dronëve ofrohen nga shumë palë të treta.

Mendimi i ekspertit është që kjo çështje në të dy rastet mund të trajtohet si devijim i vogël që nuk hton në atë që është e natyral, uht, dhe e atëherë të paktën htruara në not në kontratën e në dënimin e tëri.

Bazuar në këto që u cekën më lart, vlerësojmë se pretendimi ankimore është pjesërisht i bazuar.

Pretendimi nr.6 : Sa i përket pretendimit se marrveshja për bazën e asfaltit është nënshkruar nga një person që nuk figuron në certifikatë të biznesit, vlerësojmë se kjo është çështje e brendshme e kompanisë për të caktuar personin i cili mund të nënshkruaj marrveshje në emër të kompanisë, pavarësisht nëse figuron në certifikatë të biznesit ose jo.

Po ashtu sa i përket pretendimit se OE i rekomanduar për kontratë në ofertë ka prezantuar një set të semaforëve, mirëpo dihet qartë se seti ka 2 semafor dhe jo tre siç ka qenë kërkesa e dosjes së tenderit.

Pas analizimit të ofertës së OE të rekomanduar për kontratë, nuk kemi gjetur dëshmi se i njëjti ka ofruar dy semafor ashtu siç pretendon OE ankues..

Raportin e ekspertit shqyrtues e kanë pranuar dy Palet, AK-ja është pajtuar, ndërsa OE nuk është pajtuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli Shqyrtues pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë pretendimeve ankimore, përgjigjeve të dhëna nga eksperti i çështjes i angazhuar nga OSHP, konsideron se raportet e ekspertizës i përmbajnë apriori elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilave dispozita kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë panelin dhe të gjitha palët me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e Dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e “NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXË – LOT 1 – Ri-tenderim” me nr. të prokurimit: 623-24-8684-5-1-1.

Paneli Shqyrtues, në vlerësimin e kryer mbi paramasën e ofruar nga OE ankues, ka konstatuar disa ndryshime të sasive në tri pozita të ndryshme të specifikuar në këtë dokument.

Në pozicionin Nr. 1.4.6, i cili përfshin furnizimin dhe punimin e tamponit prej gurit të thyer gëlqeror (100MN/m²) me dimensione 0-31.5mm dhe trashësi t=20cm, është vënë re një ndryshim në sasinë e llogaritur për këtë pozicion. Në këtë rast, është përfshirë edhe sasia e nevojshme për rregullimin e gjeometrisë së kthesave dhe të drejtimit të trupit të rrugës. Sasia e llogaritur në gjendje të ngjeshur është 14,250.00 m³, e cila ndryshon nga sasia e paraqitur nga OE ankues në paramasën e tij, ku është evidentuar një sasi prej 13,950.00 m³.

Po ashtu, në pozicionin Nr. 2.3.4, që ka të bëjë me furnizimin, transportin dhe vendosjen e rerës 0-16mm në fundin e kanalit anash dhe mbi gypa, sasia e llogaritur është 1,100.00 m³. Ky ndryshim është evidentuar krahasuar me sasinë që figuron në paramasën e OE ankues, ku është paraqitur një vlerë prej 1,092.00 m³.

Gjithashtu, në pozicionin Nr. 2.3.5, i cili lidhet me mbulimin dhe planifikimin e kanalit me material mbushës CBR 15% dhe ngjeshjen në shtresa 25cm deri në trupin e rrugës, është evidentuar një tjetër ndryshim. Sasia e llogaritur për këtë pozicion është 2,750.00 m³, ndërsa OE ankues ka paraqitur një sasi prej 2,758.00 m³ në paramasën e tij.

Këto ndryshime në paramasë- në sasi janë të rëndësishme për procesin e vleresimit dhe mund të kenë ndikim në vlerën përfundimtare të kostos dhe realizimit të punimeve duke ardhur ne perfundim se saktësia e llogaritjeve të bëra nga OE ankues nuk janë në përputhje me kushtet e parashtruara ne paramasë.

Paneli duke u nisur nga ky fakt se OE tjerë pjesmarrës nga 4 sa ishin nuk i kanë prekur sasi të përcaktuara nga AK, ndërsa ankuesi ka ndryshuar sasi të në paramasë me apo pa qëllim, atëherë ankuesi ka qenë dashtë këtë ta evidentoj në fazën e para ofertimit dhe të marrë masa ta përmirësoj këtë gjë, po ashtu nëse kishte me qenë e nevojshme edhe me ankesë në AK dhe OSHP. Kurse, me rastin e ofertimit çdo OE ofertues zotohet se i ka kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e Dosjes së Tenderit kjo evidentohet edhe tek Formulari për dorëzimin e Tenderit të ankuesit i cili është i bashkangjitur në ofertën e tij, por e përcaktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve". Paneli sqaron se ndryshimi i sasive nuk ka të bëjë me gabime aritmetikore, gabimet aritmetikore janë të përcaktuar qartë tek Rregullorja e lartë cekur tek paragrafi 8 dhe 9 i nenit 41. Si rezultat i gjithë këtyre veprimeve/mosveprimeve të cituara si më sipër, paneli shqyrtues mbështet arsyetimin e autoritetit kontraktues dhe raportin e ekspertit shqyrtues.

Poashtu Operatorët Ekonomik të interesues për çfardo pjesmarrje ne procedura prokururse që ofertojnë me rastin e ofertimit zotohen se i kane kontrolluar dhe pranuar të gjitha kushtet e Dosjes së Tenderit kjo evidentohet edhe tek Formulari për dorëzimin e Tenderit i cili është i bashkangjitur në ofertën e tij, por është e përcaktuar edhe në nenin 18.3 të Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurim Publik, citat: "Pjesa C, Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në këtë pjesë ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon të gjitha kushtet e tenderit dhe dorëzon ofertën e tij financiare. Ajo përbëhet nga: Formulari i tenderit dhe Lista e çmimeve". Ne rastë se kemi të bëjmë me gabime artimetike atëher janë të përcaktuara në nein 40 të RRPP-se , paragrafi 8 dhe 9 të kësaj Rregulloreje.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik "JOOS & KRASNIQI – BAZE" SH.P.K te aprovohet si pjesërisht e bazuar.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "NDËRTIMI I RRUGËS ME KATËR KORSI NGA RAHOVECI NË XËRXXË – LOT 1 –

Ri-tenderim” me nr. të prokurimit: 623-24-8684-5-1-1 të mbetet në fuqi vendimi i AK. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik e sheh si pjesërisht të bazuar duke e mbështetur raportin e ekspertizës.

Pa nevojë për analiza tjera të pretendimeve ankimore dhe provave tjera, OSHP nisat gjithnjë nga fakti se çdo AK (në çdo nivel) gëzon pavarësinë e plotë në ushtrim e kompetencave dhe caktimin e nevojave në harmoni me kapacitet buxhetore, gjithsesi paneli shqyrtues vlerëson faktin se AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure është kujdesur ex-officio edhe për parimet bazë të LPP-së në mënyrë që gjatë vlerësimit të procedurës së prokurimit të respektoj dispozitat e LPP-së. Gjithsesi për shkak se dy pretendimet e para ankimore të OE ankues janë të qëndrueshme, paneli shqyrtues e vlerëson ankesën e OE si pjesërisht të bazuar, por pretendime këto që nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktiviteti i prokurimit ti nënshtrohet procedurës së rivlerësimit.

Paneli shqyrtues vendos ti jep të drejtë AK dhe që ta lë në fuqi B58 Vendimin e AK dhe të vazhdoj tutje me fazën tjetër të këtij aktiviteti të prokurimit, vendim ky i cili është nxjerrë nga një komision i vlerësimit i cili supozohet të jetë profesional dhe po ashtu përgjegjës sipas nenit 59.1 cituar "Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës". Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht në pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK konform nenit 24 paragrafi 2 të LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj".

Paneli Shqyrtues ka marrë parasysh edhe nenin 104 par. 4 të LPP ku përcaktohet se "*Në ndërmarrjen e masave të përcaktuara OSHP duhet të veprorë në mënyrë proporcionale me shkeljen e pretenduar ose çështjen për të cilën është paraqitur ankesa, dhe të marrë për bazë pasojat e mundshme të veprimeve ose masave në të gjitha interesat që mund të dëmtohen, duke përfshirë interesin publik*". Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues është nisur nga parimi themelor për mbrojtjen e interesit të publikut qoftë në aspektin e parandalimit të vonësive të paarsyeshme ashtu edhe në mbrojtjen e parimit të ligjshmërisë.

Andaj, paneli shqyrtues në përputhje me Ligjin për Prokurim Publik (LPP) dhe parimet themelore të tij, Autoriteti Kontraktues (AK) ka për detyrë të sigurojë që procesi i prokurimit të jetë efikas, transparent dhe i drejtë, duke trajtuar të gjithë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese. Kjo përfshin edhe detyrimin për të garantuar përdorimin ekonomik dhe efektiv të fondeve publike, duke mos kontribuar dhe prolonguar këtë aktivitet të prokurimit. Po ashtu, Paneli shqyrtues detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7 të LPP-së përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

Panelit Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Për pikën I dhe II të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 paragrafin të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimet të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KUVENDI KOMUNAL - RAHOVECË**
- **OE - JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: